



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:192806

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05488760

C.nr.3264/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit S.R nga fshati B, Komuna P, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga N.I, avokat me seli në P, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga SH.M, avokat me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 5,185.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të dt.19.03.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datën 20.03.2024 mori, ndërsa me datën 22.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit S.R nga fshati B, Komuna P, ashtu që: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit të pësuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar me datën 04.09.2017 në P, Rr. "M.F", t'ia paguajë shumat si në vijim:

-Në emër të dëmit jo material:

-Për dhimbje fizike, shumën prej.....1,100 €
-Për friken e përjetuar, shumën prej.....1,200 €

-Në emër të dëmit material:

-Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....170,00 €
-Për ndihmën e personit të tretë, shumën prej.....120,00 €
-Për shpenzimet e shërimit, shumën prej.....10,00 €

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditësit S.R, shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.20.03.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.27.11.2017, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit S.R, përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbjet fizike në shumën prej 900.00 €; për frikën e përjetuar në shumën prej 800.00 €; për ushqim të përforcuar në shumën prej 230.00 €; për ndihmën e personit të tretë në shumën prej 180.00 €; për shpenzimet e shërimit në shumën prej 25.00 €. Po ashtu, refuzohet në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të rehabilitimit klimaterik t'ia paguajë paditësit shumën prej 450.00 €.

IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S" me seli në P, që paditësit, S.R, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 486.00 € (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë euro), dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësi S.R nga fshati B, Komuna P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, N.I, avokat me seli në P, pranë kësaj gjykate me dt.27.11.2017, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S", me seli në P, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ndër tjera pretendohet se me datë 04.09.2017, rreth orës 13:30 në rrugën "M.F" në P, paditësi ka pësuar një aksident komunikacioni si pasojë e të cilit ka pësuar lëndime trupore të përcjella me dhimbje fizike, frikë, shëmtim dhe për të njejtat janë krijuar edhe shpenzime materiale. Më tej i është referuar raportit të policisë, sipas të cilit pretendohet se deri te aksidenti kishte ardhur si pasojë e lëshimeve ekskluzive të drejtuesit të automjetit "A" – ..., me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte V.K, i cili duke mos e mbajtur distancën e duhur, me pjesën e përparme e godet veturën "B" në pjesën e pasme, e cila ka qenë duke u drejtuar nga këtu paditësi, me ç'rast i njejtë kishte pësuar lëndime trupore për të cilat kishte qenë e nevojshme ndihma mjekësore. Tutje pretendohet se automjeti "A" – ..., me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte V.K, në momentin e shkakimit të aksidentit ka pasur të kontraktuar tek Kompania e Sigurimeve "S" – këtu e paditura. Paditësi ka paraqitur kërkesë për kompensimin e dëmit të shkaktuar pranë të paditurës, të cilës i takon edhe përgjegjësia për dëmshpërblim, ndërsa e paditura nuk e ka kontestuar përgjegjësinë, respektivisht bazën juridike të kërkesëpadisë, por oferta të cilën e ka parashtruar, pala paditëse e konsideron jo reale në raport me lëndimet e pësuar. Më tej në petitum të kërkesëpadisë, pala paditëse i është referuar dispozitave të së drejtës materiale nga nenet 136, 140, 159 dhe 169 par.2 të LMD-së, duke i propozuar gjykatës që të caktojë shqyrtim gjyqësor, të administrojë provat e propozuara dhe të merr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe detyrohet e paditrua që në emër të dëmit të pësuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 04.09.2017, ta kompensojë të njejtin për format e dëmit të specifikuar si në petitum të kërkesëpadisë.

Në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, paditësi përmes përfaqësuesit së autorizuar ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa me qëllim të vërtetimit të lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi si dhe frikës së përjetuar, i ka propozuar Gjykatës nxjerrjen e provës përmes ekspertizës mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, me ç'rast detyrat e ortopedit do të jenë që të përcaktojë natyrën e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen e trajtimit të tyre si dhe pasojat eventuale për paditësin, ndërsa detyrat e ekspertit të psikiatrisë do të jenë që të

përcaktojë llojin e frikës dhe kohëzgjatjen e saj. Me rastin e pranimit të ekspertizës përkatëse, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se nuk ka ndonjë vërejtje e as pyetje për ekspertët, ndërsa përmes parashtrësës së dt.19.03.2024, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor, e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, në atë mënyrë që ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të dëmit të pësuar nga aksidenti i komunikacionit i dt.04.09.2017, t'ia paguajë shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 2,000 €; për frikën e përjetuar shumë prej 2,000 €; për ushqim të përforcuar shumë prej 400,00 €; për ndihmën e personit të tretë shumë prej 300,00 €; për rehabilitim klimaterik shumë prej 450.00 €; për shpenzime mjekësore shumë prej 35.00 €. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të deklarimeve të dhëna u vërtetua baza e kërkesëpadisë, duke i propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë në shumë prej 104.00 €; për precizim të padisë shumë prej 104.00 €; për 3 seanca gjyqësore shumë prej nga 135.00 €, apo shumë prej 405.00 €, për ekspertizë mjekësore shumë prej 300.00 €, si dhe për taksë gjyqësore për padi shumë prej 60.00 €.

Pala e paditur, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se në këtë çështje juridike nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese mbetet vetëm lartësia, duke shtuar se e kanë trajtuar rastin në procedurë administrative dhe mjekët e të paditurës kanë konstatuar lëndime të lehta trupore për paditësin, andaj kanë bërë përpjekje për të arritur marrëveshje, por pala paditëse nuk ka pranuar, duke shtuar se edhe më tej mbesin pranë ofertës së parashtruar. Me rastin e pranimit të ekspertizës mjekësore, ka theksuar se nuk kanë ndonjë vërejtje e as nuk kërkojnë sqarime, duke shtuar se nga përmbajtja e kësaj ekspertize vërehet që kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore dhe pa pasoja për jetë apo punë, vlerësim ky në përputhje me mjekët e kompanisë. Më tej ka theksuar se shumtë e kërkuara në emër të kompensimit të dëmit jo material nga ana e palës paditëse janë tepër të larta dhe të pa justifikueshme, ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material që ka të bëjë me ushqim të përforcuar, kujdesin e personit të tretë dhe shpenzimet e rehabilitimit, e ka kundërshtuar në tërësi mbi bazën e pretendimit se lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë nuk janë ofruar prova materiale. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave në këtë çështje juridike, rezulton që baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, por kontestuese mbetet vetëm lartësia e kërkesëpadisë, duke i propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit, përtej shumës së ofruar nga e paditura ta refuzojë si të pa bazuar. Më tej e ka kundërshtuar edhe kamatën e kërkuar nga dita e parashtrimit të padisë, me pretendimin se është në kundërshtim me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, si dhe i ka propozuar Gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit definitiv të ketë parasysh vërejtjet lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë si dhe lidhur me shpenzimet e procedurës të zbatohet parimi i suksesit në procedurë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

- Gjendja faktike e vërtetuar në bazë të provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.19.03.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat materiale vijuese: Raporti i aksidentit Nr.2017-AR-2364, i datës 04.09.2017 së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes; Dëftesat Nr.0108531, e dt.12.09.2017; Nr.0103708, e dt.05.09.2017; Nr.096984, e dt.06.09.2017; Nr.118711, e dt.04.09.2017; Raporti i lëshuar nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, me dt.04.09.2017;

Raporti me numër protokoll 35593, i dt.04.09.2017, i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë; Raporti nga konsulta i dt.06.09.2017; Raporti i dt.06.11.2017; Ekspertiza mjekësore e dt.16.02.2024, e përpiluar nga Dr. H.G – Ortoped – Traumatolog dhe Dr. S.B – Psikiatër.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse nuk kanë parashtruar vërejtje në raport me provat e administruara.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se me dt.04.09.2017, rreth orës 13:30 në rrugën “M.F” në P, është shkaktuar aksident i komunikacionit, deri te i cili aksident kishte ardhur si pasojë e lëshimeve ekskluzive të drejtuesit të automjetit “A” – ..., me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte V.K, i cili duke mos e mbajtur distancën e duhur, me pjesën e përparme e godet veturën “B” në pjesën e pasme, e cila ka qenë duke i drejtuar nga këtu paditësi.

Po ashtu, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se automjeti “A” – ..., me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte V.K, në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S”. Në raport me vërtetimin e fakteve të tilla, Gjykatës në cilësinë e provës materiale i ka shërbyer Raporti i aksidentit Nr.2017-AR-2364, i datës 04.09.2017 së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes, ndërsa meqenëse mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza e kërkesëpadisë, e as nuk janë dhënë propozime për nxjerrjen e provave të reja në këtë drejtim, Gjykata nuk është thëlluar më tutje në vlerësimin e gjendjes faktike në raport me këtë sferë, në kuptim të dispozitës së nenit 321 par.2 të LPK-së, ku përcaktohet: *"Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor."*

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ka ngelur çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, lidhur me të cilën palët ndërgjyqëse kanë paraqitur pikëpamje të ndryshme, me ç'rast pala e paditur pretendon se shumata e kërkuara nga ana e palës paditëse nuk i përgjigjen plotësisht vëllimit të dëmit të pësuar për paditësin nga aksidenti i komunikacionit.

Nga dokumentacioni mjekësor i bashkangjitur në shkresat e lëndës, respektivisht raporti i lëshuar nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, me dt.04.09.2017; raporti me numër protokoll 35593, i dt.04.09.2017, i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë; raporti nga konsulta i dt.06.09.2017 dhe raporti i dt.06.11.2017 vërtetohet se paditësi si pasojë e aksidentit i është nënshtruar tretmanit mjekësor të nevojshëm pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me ç'rast fillimisht është dhënë diagnoza lidhur me natyrën e lëndimeve, ndërsa më tutje ky tretman është përcjellë me ndjekjen e terapive të rekomanduara lidhur me lëndimet e pësuar nga mjekët përkatës.

Në bazë të provave materiale - dëftesave Nr.0108531, e dt.12.09.2017; Nr.0103708, e dt.05.09.2017; Nr.096984, e dt.06.09.2017 dhe Nr.118711, e dt.04.09.2017, vërtetohet fakti se për shërbimet e ofruara pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, paditësi ka paguar shumën e përgjithshme në vlerë prej 10.00 €.

Sipas propozimit të palës paditëse, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore, dhe atë me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë, respektivisht e psikiatrisë, me ç'rast për ekspertë janë caktuar Dr. H.G - Ortoped - traumatolog dhe Dr. S.B - Psikiatre. Ekspertët e lartëcekur kanë pasur për detyrë që në bazë të njohurive profesionale, pas ekzaminimit të paditësit dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të japin mendimin e tyre profesional lidhur me shkallën dhe intensitetin e lëndimeve të pësuar, dhimbjeve fizike, frikës, si dhe të konstatojnë nëse ta paditësi si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka ardhur në shprehje zvogëlimi i aktivitetit jetësor, shëmtimi dhe nëse ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë. Po ashtu, detyrat e ekspertëve kanë konsistuar në vlerësimin e faktit nëse shpenzimet e shërimit i përshtaten natyrës së lëndimeve të pësuar.

Ekspertët e lartëcekur kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim me dt.16.02.2024, ndërsa po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesor ka prezantuar Dr. Halit Gërbeshi, i cili në emër të grupit të ekspertëve ka dhënë sqarimet nga ekspertiza përkatëse. Palët ndërgjyqëse kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje ndaj kësaj ekspertize e as nuk kërkojnë sqarime shtesë nga ekspertët e lartëcekur. Në mendimin e dhënë, ekspertët fillimisht kanë konstatuar se bazuar në raportet mjekësore, ekzaminimin klinik të të aksidentuarit dhe përvoja profesionale kanë ardhur në përfundim se pala paditëse ka pësuar këto lëndime trupore : *“Dg:-Car acc; Dhimbje të qafër dhe shpinës; Dg: - Car acc; Shtypje e dermishjes së qafës dhe regjionit krahroro – belor; Dg: - Reagim akut në stres – F 43.0; Interpretimi – pa ndryshime traumatologjike; Dg – Gjysmë mpirjet e anës së majtë.”.* Sipas ekspertëve përkatës, lëndimet e tilla kualifikohen si lëndime të lehta trupore.

Në raport me dhimbjet fizike, ekspertët përkatës kanë konstatuar se paditësi nuk ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë; dhimbje të intensitetit të rëndë ka përjetuar për 2 ditë – për shkak të shtypjes dhe zgjatjes së indeve të buta, të përcjella me endemë dhe gjakmbledhje rreth indeve tjera të afektuara në lëndime të cilat janë evidente në 48-72 orët e para pas aksidentit, dhimbje të cilat shfaqen kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes; dhimbje të intensitetit të mesëm ka përjetuar për periudhë prej 12 ditësh – kohë kjo deri në fillimin e rënies së endemave si dhe fazës së absorbimit të gjakmbledhjes rreth indeve dhe rifillimit të konsolidimit të indeve të buta të afektuara; dhimbje të intensitetit të lehtë ka përjetuar për 25 ditë – periudhë kjo kur indet e buta janë në fazën e rivitalizimit të plotë në koherencë me lëndimet e pësuar që manifestohen me dhimbje të lehta në ndryshime klimatike apo edhe sforcime fizike.

Zvogëlim të aktivitetit jetësor është konstatuar se nuk ka.

Në raport me frikën e përjetuar, është konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e përcjellë me frikë nga vdekja dhe kërcënimi serioz për integritetin e tij trupor; frikë sekondare të intensitetit të lartë – e cila është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, frikë nga procedurat mjekësore, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes, çrregullim disponimi dhe ankesa të shumta somatike, e cila ka zgjatur për 48 orë; frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe më të ulët, e cila ka zgjatë për 3 deri në 4 muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, lodhje në angazhimet minimale, zgjime të herë pas hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike; frikë dhe pasiguri që e ka edhe sot e kësaj dite gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, por të intensitetit më të ulët.

Shëmtim trupor është konstatuar se nuk ka.

Tutje në mendimin dhe konstatimin e dhënë, ekspertët përkatës kanë konstatuar se ushqimi i përforcuar si pasojë e aksidentit ka qenë i nevojshëm për 17 ditë – nga dita e lëndimit dhe atë: ushqim i pasur me proteina, vitamina, minerale dhe karbohidrate, kohë kjo e nevojshme për konsolidimin e indeve të buta si dhe një mekanizëm mbrojtës i forcave imunobiologjike të organizmit si luftë kundër proceseve inflamatore nga hematoma e pësuar. Ndiham dhe kujdesi nga personi i tretë ka qenë i nevojshëm për 12 ditë, ngase i dëmtuari ka mbajtur pozicion të detyruar të shtrirë në shtrat apo gjysëm të shtrirë, me ç'rast i është nevojitur ndihmë rreth veshmbathjes dhe higjenes personale. Rehabilitimi klimaterik ka qenë i nevojshëm për 10 ditë në një nga banjat e vendit apo përmes fizioterapisë, qendra këto të cilat ndihmojnë në rivitalizimin e indeve të dëmtuara si dhe kthimin e lëvizjeve në normalitet.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, gjegjësisht përgjigjes në raport me pretendimet e parashtruara nga palët ndërgjyqëse, referuar natyrës dhe momentit kur është krijuar raporti juridik, duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.10.05.2012, i cili ligj ka hyrë në fuqi 6 muaj pas datës së publikimit. Dispozita nga neni 136, e cila i referohet bazave të përgjegjësisë për kompensimin e dëmit përcakton që: "*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*". Neni 137 i këtij ligji përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: "*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fëtimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*". Në këtë mënyrë, nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur rezulton se ekzistojnë dy kategori të dëmit: 1) dëmi material, i cili ndahet në dy nënkategori: 1) zvogëlimi i pasurisë dhe 2) pengimi i rritjes së saj dhe 2) dëmi jo material, i cili konsiston në shkaktim të dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës. Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definon dispozita e nenit 169 të këtij ligji, e cila parasheh që: "*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme*". Në funksion të njejtë, dispozita e nenit 174 përcakton që: "*Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të silllet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim*". Në anën tjetër, çështja e shpërblimit të dëmit jo material përcaktohet me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla,*

pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror."

- Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës -

Në rastin konkret, në bazë të të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartëcekura, rezulton se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt.04.09.2017, ka pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike dhe frikë), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar dhe shpenzime të shërimit). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intentsitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore të dt.16.02.2024, të punuar nga ekspertët Dr. H.G - Ortoped - traumatolog dhe Dr. S.B - Psikiatre. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizës në fjalë ia fali besimin e plotë, për faktin se është përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje. Krahas vërtetimit të faktit se paditësi ka pësuar format e lartëcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njejtit. Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësin është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të të paditurit për pagesën e një shume të të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,100 Euro, duke marrë në referencë intentsitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore, ku theksohet se paditësi si pasojë e aksidentit nuk ka përjetuar dhimbje fizike të intentsitetit posaçërisht të rëndë; ka përjetuar dhimbje fizike të intentsitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur 2 ditë; dhimbje fizike të intentsitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 12 ditë, si dhe dhimbje fizike të intentsitetit të ulët të cilat kanë zgjatur 25 ditë.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,200 Euro, po ashtu duke marrë në referencë intentsitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti i pësuar, të specifikuar në ekspertizën mjekësore, ku është konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda; frikë sekondare të intentsitetit të lartë e cila ka zgjatur 48 orë, frikë sekondare të intentsitetit të mesëm - e cila ka zgjatur edhe për 3 deri në 4 muaj; frikë dhe pasiguri me të cilën ballafaqohet edhe sot gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Lidhur me shumën e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A – Su.A 41/2023, të dt.27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kritere orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ushqimit të përforcuar, t'ia paguajë paditësit shumën prej 170.00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është

konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 17 ditësh.

Sa i përket ndihmës së personit të tretë, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 120.00 Euro, duke marrë për bazë faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën kohore prej 12 ditësh.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (nevoja për ushqim të përforcuar dhe ndihma e personit të tretë), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkaktimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirësuar për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit, në mbështetje të dispozitës nga neni 323 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.”*

Lidhur me shpenzimet e shërimit, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 10.00 Euro. Kjo për faktin se në bazë të provave materiale - dëftesave Nr.0108531, e dt.12.09.2017; Nr.0103708, e dt.05.09.2017; Nr.096984, e dt.06.09.2017 dhe Nr.118711, e dt.04.09.2017, vërtetohet fakti se për shërbimet e ofruara pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, paditësi ka paguar shumën e përgjithshme në vlerë prej 10.00 €.

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I të dispozitivit e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuar në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin jo material, shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditësit, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Në raport me dëmin material të pësuar, Gjykata vlerëson se shumat e përcaktuara janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarit - këtu paditësit në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi.

- Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë -

Gjykata në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të dëmit jo – material, dhe atë: për dhimbjet fizike në shumën prej 900.00 €; si dhe për frikën e përjetuar në shumën prej 800.00 €. Po ashtu, u refuzua si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit në emër të kompensimit të dëmit material përtej shumave të gjykuara dhe atë: në emër të ushqimit të përforcuar në shumë prej 230.00 €; ndihmë të personit të tretë në shumë prej 180.00 €, si dhe shpenzime të shërimit në shumë prej 25.00 €. Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësit në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin

e një gjendje e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirën e cënuar.

Në raport me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve lidhur me rehabilitimin klimaterik, Gjykata mori në konsideratë faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se rehabilitimi klimaterik si pasojë e aksidentit për paditësin ka qenë i nevojshëm për 10 ditë. Megjithatë, pala paditëse nuk ka prezantuar ndonjë provë materiale në drejtim të argumentimit të lartësisë së këtyre shpenzimeve, ndërsa vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se shpenzimet e tilla, ndryshe nga ato që kanë të bëjnë me nevojën për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, lehtësisht mund të argumentohen përmes provave konkrete materiale. Mbi këtë bazë, u refuzua në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të rehabilitimit klimaterik t'ia paguajë paditësit shumën prej 450.00 €.

- Vendimi lidhur me kamatën -

Gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën akcesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjetuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjetuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.20.03.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjetuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.27.11.2017, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

- Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës -

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika IV e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452 par.2, 453, lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në fjalë përfundimtare, i autorizuari i palës paditëse ka paraqitur kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve të kësaj procedure dhe atë: për përpilim të padisë në shumë prej 104.00 €; për precizim të padisë shumën prej 104.00 €; për 3 seanca gjyqësore shumën prej nga 135.00 €, apo shumën prej 405.00 €, për ekspertizë mjekësore shumën prej 300.00 €, si dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 60.00 €, që rezultojnë në shumë të përgjithshme prej 973.00 €. Bazuar në faktin se pala paditëse pjesërisht ka pasur sukses në këtë proces gjyqësor, Gjykata në mbështetje të dispozitës nga neni 452 par.2 të LPK-së, vendosi që ta obligojë palën e paditur që t'ia paguajë palës paditëse shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 486.00 €, shumë kjo të cilën Gjykata e konsideron proporcionale me suksesin e arritur.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni- Civil-
C.nr.3264/17, datë 22.03.2024

G j y q t a r i,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 176 të LPK-së, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.